



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË**

Korçë, më 05.02..2026

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR PUNONJËS SHËRBIMI

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë punonjës shërbimi, që do të kryejë detyrat e ngarkuara në ligj dhe në rregulloren e brendshme të institucionit. (Rregulloren e gjeni në: https://www.pp.gov.al/Korce/Programi_i_Transparences_16657/).

Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- Të jetë e gjinisë femër;
- Mundësisht të ketë eksperiencë si punonjëse apo si stazhiere në administratë.

Personat e interesuar duhet të paraqitin në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim ku të jepen adresa dhe numri i kontaktit;
2. Fotokopjen e diplomës të shkollës së mesme dhe të listës të notave, të noterizuara;
3. Fotokopje të kartës të identitetit dhe certifikatë personale.
4. Dëshmi të eksperiencës së punës.
5. Një jetëshkrim (CV) të shkurtër.

Kandidatët mund të paraqitin:

- Dëshmi të kualifikimeve pas shkollës së mesme;
- Dëshmi të njohurive në programet kompjuterike MSOffice- Word dhe Excel;

Dokumentat do të dorëzohen në kryesekretarinë e Prokurorisë. Pranimi i aplikimeve mbyllet në datën 19.02.2026.